**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr. 3298/6 Prot.                                                                 Pogradec, më 25.08. 2026

**VENDIM**

**NR. 99, DATË 24.08.2026**

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 29.07.2026 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 29.07.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 29.07.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZV/KRYETARE E KËSHILLIT**

**Miranda OLLDASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**1.Miratuar me** 17 **vota**
**2.Vota Pro** 17
**3.Vota Kundër** 0
**4.Vota Abstenim** 0
**5.Zbardhur më date** 24.08. 2026

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

ORA : 12:00

JANË PREZENT KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 29.07.2026, ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim** :Miratimi i Procesverbalit të datës 29.06.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 29.06.2026.
5. **Projekt – Vendim:**Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për një rishpërndarje në VKB Nr 128 dt 22.12.2025 "Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"
7. **Projekt – Vendim:** Miratimin e Tavaneve Përfundimtare të Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec.
8. **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026", I ndryshuar.
9. **Projekt – Vendim: Miratimin e përfudimit të procedurave të privatizimit të banesave,të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjensinë shtetëroretë kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit.**
10. **Projekt – Vendim:Miratimin e listës përfundimtare të Bashkisë Pogradec në kuadër të thirrjes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për programin e subvensionit të interesave te kredisë.**
11. **Projekt – Vendim:Për dhënien e ndihmës financire për znj.Fatbardha Beqiri.**
12. **Të tjera.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 09.06.2026**

**1.Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.

**Znj. Kamolli (Kryetare e Këshillit):** Përshëndetje! Jemi mbledhur për zhvillimin e mbledhjes së radhës. Materialet ju janë vënë në dispozicion si në mënyrë elektronike, ashtu edhe në formë shkresore.

Kemi tre projekt-vendime shtesë te cilët I prezantuam në mbledhjen e komisjoneve.

Dokumentacionin e kanë në rregull kështu që I futim në rendin e ditës .

Ju lutem, të bëhet prezenca.

**Znj. Bojko:** Prezente janë 19 këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.

**Znj. Kamolli:** Vazhdojmë me rendin e ditës,po e lexoj dhe e hedhim ne votim.

**U votua**

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **PO** **JO**

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

**2-Projekt – Vendim** :Miratimi i Procesverbalit të datës 29.06.2026.

**Znj. Kamolli:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Kush është dakord, e hedhim në votim.

**U votua**

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** **Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

- **Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.**

**Znj. Kamolli:** Ju lutem, nëse dikush ka konflikt interesi, le ta deklarojë.



**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

- **Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 29.06.2026.**

**Znj. Kamolli:** Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të dit. Lexohet vendimi i Prefekturës.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

**Projekt – Vendim**: Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2026.

**Znj. Kamolli:** Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës. Fjalën e merr znj. Lulejetë.

**Znj. Luljeta:** Për muajin qershor 2026 janë trajtuar gjithsej 122 familje, me një fond në vlerën 482,909, lekë. Krahasuar me muajin e kaluar, gjatë këtij muaji janë trajtuar më pak familje.

**Znj. Kamolli:** Në rregull. Nëse nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë për miratim me votim. Ju lutem, kush është dakord?

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** (rrethuar) **Jo**

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

**Projekt – Vendim:** Për një rishpërndarje në VKB Nr 128 dt 22.12.2025 "Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"

**Znj. Kryetare:** Vazhdojme me projekt vendimin e radhes.

Ështe një rishpërndarje në buxhet .

Znj.Karapanxha :Ky projekt vendim ka të bëjë me një rishpërndarje fondi .Fondi do të hiqet nga objekti "Ura e zëmcës –Kryqëzimi Proptisht-Bishnicë",dhe do të vendoset për rehabilitimin e godinës së ish-Gjeologjis.

Ky object ka vite që perpiqet për kompletimin e dosjes për marrjen e pronësis së saj.

Godina do të përdoret për strehim social.

Objekti "Ura e Zëmcës-Kryqëzimi-Proptisht-Bishnicë" do të kryet likujdimi I tij kur të dorëzohet pranë bashkisë situacioni përkates.

**Znj. Kryetare:** Kjo do t'i vi në ndihmë komunitetit.

**Z.Torra:** Do të dalin gjashtë banesa ,të cilat do të përdoren për strehim social.

Z.Shyti:Të gjitha katet janë për strehim ?

Z.Torra:Vetëm katin e 3-4 kemi ne.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim piken nr.5 të rendit të ditës

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim 0**

**Miratohet** **Po** **Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

**Projekt – Vendim:** Miratimin e Tavaneve Përfundimtare të Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projekt-vendimin e radhës.

Znj.Karapanca:Ndryshimet për tavanet buxhetore I kemi sjelle qe të hënën e parë. Nuk kemi berë ndryshime .

Tavanet janë në fazën përfundimtare

Z. Haxhillari: Shumë shkurt ,kjo është një fazë që ne e kemi bërë cdo vit.

Kemi bërë një analizë të detajuar sipas llogarive .

Në përgjithësi ,buxheti I vitit 2027- 2029 reflekton një rritje të qëndrueshme dhe prioritete te qarta për zhvillimin ekonomik dhe inftastrukturor.

Cdo gjë eshtë konsultuar edhe në mbledhjen e komisioneve.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim projekt-vendimin 7.

**Pro** 19

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** **Jo**

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

**Projekt – Vendim:** Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026", I ndryshuar

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projekt-vendimin e radhës: "Për një shtesë në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 "Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec, për vitin 2026", I ndryshuar.

E diskutuam në komisione por të degjojmë specialistin.

Z.Klajdi:Ndryshimi I hartës ka ndodhur për shkak të dy ankesave që kanë mbërritur në fshatin Mëmëlisht.

Është evidentuar nevoja për një vendbazimi për varkat e peshkimit në zonën e mëmëlishtit,për sistemimin e mjeteve lundruese të peshkimit dhe organizimin më të mirë të mjeteve të peshkimit .

Duhet që ta përcaktojmë në hartë që do të përdoret për mjetet e peshkimit.

Ajo per peshkimet po përdoret,por duhet te percaktohet ne harte.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim projekt-vendimin 8.

**Pro** 21

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** **Jo**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** **Pogradec më 29.07.2026**

**9.Projekt – Vendim:** Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjencinë shtetërore të kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projekt-vendimin e radhës: '' Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjencinë shtetërore të kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit **".**

Z.Dulellari;Ky projekt – vendim synon të përfundojë procedurën e privatizimit të banesave te cilat kanë mbetur të paregjistruara ne AKSH ,për lidhjen e kontratave përpara noterit sipas listës emerore te bashkëlidhur .

Kjo do hëhët për rifreskim të kartelave të pasurive.

Ky projekt-vendim vjen si një ngërc formal mes qytetarve dhe AKSH-s.

Pork y projekt –vendim do të zbardhet me ndryshim,sepse personi me nr.5 ne listë z.Gjergji Ibrahimi do të hiqet nga lista sepse e ka mare certifikatën.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim projekt-vendimin 9.

**Pro** 21

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** **Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**10.Projekt – Vendim:** Miratimin e listës përfundimtare të Bashkisë Pogradec në kuadër të thirrjes nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për programin e subvencionimit të interesave të kredisë.

**Znj. Kamolli:** Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së dhjete të rendit të ditës. Ju lutem.

z.Dulellari:
Sipas programit qe na detyron Ministria kemi shqyrtuar të gjitha këerkesat për të përfituar nga programet e strehimit social.

Të gjitha rastet u trajtuan komform ligjit ,u përgatit dokumentacioni tekniko-ligjor sipas ligjit ,u verifikuan kerkesat por kemi vetem 30 kuota nderkoh qe kerkesat jane me të larta.

Kemi qene te kujdesshem qe te gjith pretendentet të jene ne rregull me dokumentacinin.

Kemi bërë kërkese për shtim kuotash meqe të gjithë I plotësojnë kërkesat.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim projekt-vendimin nr.10

**Pro** 21

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** **Jo**

**11.Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare për znj.Fatbardha Beqiri

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me dhënien e ndihmës financiare për znj.Fatbardha Beqiri,zonjen e elektricistit që humbi jeten ne vendin e punes.Ngushëllime familjes.

Dhënia e ndihmës financiare është në masën 500.000 lekë.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim projekt-vendimin nr.11.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim projekt-vendimin 9.

**Pro** 21

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (**Po**) **JO**

Sekretare e Keshillit
Jona Bejko.